



Prishtinë, 11 nëntor 2010
Kodi i ZRRE-së: V_298_2010

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Nenin 15, 26 dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 37 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
3. Dispozitat e Nenit 37 të Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare; dhe,
4. Kërkesën për vazhdim të licencës për furnizim/tregti me energji elektrike, të bërë me datë 11 qershor 2010 nga ndërmarrja "CEZ, a.s.", adresa: "Duhova 1444/2, 140 53 Prague 4, Republika e Çekisë":

Në seancën e mbajtur më 11 nëntor 2010 nxori këtë:

VENDIM

- I. **VAZHDOHET** vlefshmëria e licencës për furnizim/tregti me energji elektrike e ndërmarrjes "CEZ, a.s.", Nr. ZRRE_Li_20/06 për periudhën nga **30 tetor 2010** deri më **30 tetor 2012**.

Arsyetim

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 11.06.2010 ka pranuar kërkesën e ndërmarrjes "CEZ, a.s." për vazhdim të licencës për furnizim/tregti me energji elektrike, e cila ndërmarrje ka qenë e licencuar në ZRRE nga data **30.10.2006 – 30.10.2008** dhe i është vazhduar licenca për herë të parë nga data **30.10.2008 – 30.10.2010**.

Zyra e Rregullatorit për Energji ka vlerësuar aplikacionin e ndërmarrjes në fjalë, dhe ka kërkuar plotësimin e dokumenteve që mungonin apo nuk përkonin me ato që kërkoheshin në Aplikacion.

Duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuar në hyrje të këtij vendimi, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante të bashkangjitura aplikacionit, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vazhdim i licencës për Furnizim/tregti me energji elektrike edhe për dy vite tjera duke filluar nga data e skadimit të periudhës së vazhdimit të parë (30.10.2010) të vlefshmërisë së licencës, i lejon ndërmarrjes së licencuar të kryej **vetëm aktivitetin e tregtisë** së energjisë elektrike.

Nëse i Licencuari “CEZ, a.s.” dëshiron të zhvillojë edhe aktivitetin e **furnizimit** me energji elektrike, të përcaktuar në Nenin 4 të licencës, ai duhet të ri aplikojë, duke plotësuar kushtet që nevojitet për këtë aktivitet, sipas udhëzimeve të ZRRE-së.

Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit nga Bordi dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund t’i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRrE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar.